



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:207436

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05406663

P.nr.992/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN- Departamenti i Përgjithshëm Penal, gjyqtari gjykues Fatmir Krasniqi, me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit **A.H.**, nga Prizreni, për shkak të vepres penale lëndim i lehte trupor nga neni 185 par.1 lidhur me nenpar.1.4 te KP-es, i akuzuar me aktakuze PP.nr.805-7/2023 të datës 29.09.2023, me datë **04.03.2024** morri këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET, marreveshja për ndermjetesim e lidhur në mes të akuzuarit **A.H.**, nga Prizreni, ku edhe tani jeton, në rr..... nr....., dhe të demtuarit **D.M.**, nga Arbana-Prizren, rr..... pnr, të ndermjetesuesit, në qendren e ndermjetesimit në Prizren Ndm.nr.77/2024 të dt.29.02.2024.

HUDHET aktakuza dhe **PUSHOHET** procedura penale kundër të akuzuarit **A.H.**, nga Prizreni, ku edhe tani jeton, rr.Engjell Berisha nr.93, për shkak të vepres penale lëndim i lehte trupor nga neni 185 par.1 nenpar.1.4 te KP-se,

Në kuptim të nenit 12.5 dhe 14.4 te Ligjit për ndermjetesim.

Shpenzimet procedurale bijnë në barrë të mjeteve bugjetore të kësaj gjykate.

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Prizren pranë Gjykatës Themelore – departamenti i përgjithshëm në Prizren, ka parashtruar aktakuze PP.nr.805-7/2023 të dt.29.09.2023, kundër të akuzuarit **A.H.**, nga Prizreni, për shkak të vepres penale lëndim i lehte trupor nga neni 185 par.1 nenpar.1.4 te KP-se.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor fillestar për dt.29.02.2024, në të cilën seance kanë prezentuar palet në procedure dhe atë prokurori themelor i shtetit Merita Gaka, i akuzuari **A.H.**, nga Prizreni, dhe i demtuari **D.M.**, nga Arbana-Prizren.

Me propozimin dhe pajtimin e paleve, te akuzuarit, e te demtuarit te cilet i kane propozuar gjykates qe kete çeshtje te dergoj ne proceduren e ndermjetesimit dhe pas dhenjes se mendimit dhe pajtimit nga prokurori themelor i shtetit Merita Gaka, gjykata me aktvendim e pranoj propozimin e paleve ne baze te ligjit te ndermjetesimit dhe dispozitave te KPPK-es.

Me dt.29.02.2024 ne qendren e ndermjetesimit ne Prizren me nr.reference Ndm.nr.77/2024, eshte lidhur marreveshja per zgjidhjen e ndermjetesuar ndermjet te akuzuarit A.H., dhe te demtuarit D.M.,.

Gjykata pas shiqimit dhe vleresimit te marreveshjes per ndermjetesim konstatoi se palet pa ndonje kercnim dhe me vet deshire kane shprehur gadishmerin qe kjo çeshtje te zgjidhet me ndermjetesim dhe nuk kane kontestuar asnje nga pikat e marreveshjes se ndermjetesimit, andaj vendosi qe te aprovoj marreveshjen si te bazuar.

Andaj Gjykata në kuptim te nenit 358 par. 1, nenpar.1.3 të KPP-se, e lidhur me nenin 12.5 dhe 14.4 te Ligjit per ndermjetesim dhe nenit 185 par.1nenpar.1.4 te KPKse, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muarr në kuptim të nenit 454 par.2 të KPPK-ës.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i pergjithshem penal
P.nr.992/2023 te dt.04.03.2024

Sekretare Juridike
Fatime Bajraktari

Gjyqtari
Fatmir Krasniqi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa

Numri i lëndës: 2023:207436
Datë: 04.03.2024
Numri i dokumentit: 05406663